

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë

LIÇENCË
PËR
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE

Numri i Liçensës:

Certifikata e Regjistrimit:

Seria:

Data e Hyrjes në Fuqi:

Liçenca i jepet:

Shoqëria:

NUIS:

Detyrimi për shërbimin publik: _____

Data e hyrjes në fuqi :

Kohëzgjatja :

Furnizues i mundësisë së Fundit : _____

Data e hyrjes në fuqi :

Kohëzgjatja :

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në seksionin e dytë të Pjesës së Peste të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjië Elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”) i jep këtë Liçencë (“Liçenca”), për të kryer veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (FEE), dhe/ose të Furnizuesit të mundësisë së fundit ose/dhe për të përmbushur detyrimin e shërbimit publik/universal, Personit të lartpërmendur, i quajtur “I Liçensuari”, subjekt i Kushteve të Liçencës të bashkangjitura dhe pjesë integrale të saj, si dhe kushteve të percaktuara në Vendimin e Bordit të ERE-s.

Kjo Liçencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi, deri në përfundim të afatit të dhënë në rast se nuk hiqet nga ERE në përputhje me Kushtet e Liçencës të përfshira këtu , apo sipas parashikimeve të ligjit 43/2015 .

KRYETAR I ERE-s

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë

KUSHTET E LIÇENCËS

Për

VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TE ENERGIJE
ELEKTRIKE

Seria: _____

Numri i Liçensës: _____

I jepet:

(Emri i plotë i të Liçensuarit)

1. Dispozita të Përgjithshme

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur në Seksionin II të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” për të leshuar dhe deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj Liçence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj Liçence behet nul ose i anulueshem apo pushon se qeni në fuqi, ky kusht do të hiqet nga Liçenca dhe Kushtet e mbetura të Liçencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

1.3 Asetet nuk mund të transferohen tek asnjë Person tjetër pa aprovimin paraprak me shkrim të ERE-s. Përfundim nga detyrimi për marrjen e miratimit të ERE për transferimin e asetëve, bëjnë rastet e parashikuara në “Rregulloren për transferimin e asetëve” Kur aprovon një transferim, ERE mund ta ndryshojë kohëzgjatjen e Liçencës ose Kushtet e tjera të saj.

1.4. ERE ka të drejtën ekskluzive për të modifikuar këtë liçensë, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar si dhe për të përmbushur dispozitat e Rregullave të Tregut, Kodit të Rrjetit, Kodit të Shpërndarje, Kodit të Matjes apo akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE sipas Legjislacionit në fuqi.

1.5. Në këtë Liçencë përfshihen Kushtet e Liçencës dhe Aneksat e saj, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e përdorur do të kenë kuptimet sipas Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si vijon:

“Operator i Rrjetit” është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

“Person” është një person juridik.

“Shërbimi i balancimit” është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

“Biznesi Shoqëruar” Çdo biznes që direkt ose indirekt, teresisht ose pjesërisht:

- a) është prone e të Liçensuarit; ose
- b) ka të Liçensuarin në pronësi; ose
- c) është në pronësi të Personit, i cili është prone e të Liçensuarit.

“Ndër-subvencionimet” Transferim fondesh ose ndarje kostosh brenda llogarive të të Liçensuarit ose mes Bizneseve Shoqëruese për mbeshtetje financiare të nje aktiviteti ose biznesi me koston e nje tjetri.

2. Kryerja e Aktivitetit të Liçensuar

2.1 I Liçensuari autorizohet nga kjo Liçence për të zhvilluar Aktivitetin Furnizuesit të Energjisë Elektrike sipas Legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë

2.2 I Liçensuari nuk do të vendose për klientët e tij pagesa të ndryshme nga ato të aprovuara nga ERE sipas Legjislacionit në fuqi.

2.3 I Liçensuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të tentojë të parandalojë të liçensuarit e tjere ose pjesëmarrësit potenciale ose konkurrentet që të angazhohen ose të hyjnë në biznesin e furnizimit apo në aktiviteteve të tjera në sektorin e energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë;

2.4 I Liçensuari nuk do të përfshihet në Nder-Subvencionime. Nëse i Liçensuari është një kompani vertikalisht e integruar elektroenergjitike, do t'i ndajë llogaritë e tij financiare sipas aktiviteteve të prodhimit dhe shpërndarjes brenda afatit të kërkuar nga Legjislacioni në fuqi për të mundësuar që ERE të konkludojë se nuk ka ndër-subvencionime, aktivitete anti-konkurrencë ose diskriminim.

2.5 I Liçensuari nuk do të përfshihet në asnjë formë aktiviteti monopol ose anti-konkurrence të ndaluar nga Legjislacioni në fuqi ose Rregulloret dhe Rregullat e miratuara nga ERE dhe Autoriteti i Konkurrencës.

2.6 Brenda datës 31 janar të çdo viti, i Liçensuari do t'i dërgojë ERE-s një informacion dhe deklaratë me shkrim për kryerjen e aktivitetit gjatë vitit paraardhës dhe përmbushjes së kuadrit ligjor në sektorin e energjisë elektrike.

2.7 I Liçensuari nuk do të bashkepusojë me persona të tjere për të demtuar interesat të liçensuarve ose klienteve të energjisë elektrike

2.8 I Liçensuari do t'a kryejë Aktivitetin e Liçensuar në përputhje me parimet e transparencës, të përcaktuara legjislacioni në fuqi

2.9 I Liçensuari që do të angazhohet në aktivitete të tjera të ndryshme nga Aktiviteti për të cilin është liçensuar duhet të informojë ERE-n në rastet kur synon të:

-
- a) angazhohet në aktivitet tjetër përveç aktivitetit të licencuar; ose
 - b) të ngreje një Biznes Shoqerues.

2.10 ERE mund ta ndalojë angazhimin në një aktivitet tjetër ose të vendosë kushte të veçanta për ngritjen e Bizneseve Shoqeruese të nevojshëm për të mbrojtur interesat e konsumatoreve. Në rast se I licencuari nuk përmbush kërkesat e përcaktuara nga ERE, ndaj tij mund të merren masa administrative sipas ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, përfshirë heqjen e licences.

2.11 I Licencuari është i autorizuar të vendosë pagesa të aprovuara nga ERE.

2.12 I Licencuari nuk është përgjegjës për mos-përmbushjen e Kushteve të Licences në rast të një Force Madhore deri në atë shkallë sa Forca Madhore është shkaku për këtë mos-përmbushje të Kushteve të Licences. Në këtë rast, i Licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të licensuarit e tjerë ose konsumatorët me të cilët i Licencuari ka lidhur marrëveshje.

3. Detyrimet e të Licencuarit

3.1. I Licencuari është i detyruar të zbatojë Legjislacionin në fuqi dhe gjithë Vendimet e Qeverisë dhe Rregulloret e Rregullat e miratuara nga ERE.

Furnizuesi, në zbatim të kësaj license, ka detyrimin të furnizojë klientët me energji elektrike, në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

3.2. Furnizuesi është përgjegjës përballë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për çdo disbalancë të shkaktuar. Përveç rasteve kur Këshilli i Ministrave ka vendosur për përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat, Klientët fundorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara, sipas akteve nënligjore të miratuara nga ERE për rregullat e balancimit.

3.3 Furnizuesi, përveç detyrimeve të përgjithshme, të përcaktuara në kontratë, dhe në Kushtet e përgjithshme për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik të siguruar nga pjestari i tregut i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, informon klientët e tij për:

- a) të drejtën e tyre për të zgjedhur dhe për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të energjisë elektrike;

b) konsumin dhe kostot aktuale të energjisë elektrike, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të energjisë nga ana e klientëve;

c) mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm;

ç) mundësinë e përdorimit të procedurave të thjeshta për ndjekjen e ankesave të tyre;

d) ndryshimin e kushteve të kontratës të paktën 15 ditë përpara zbatimit të tyre, duke përfshirë informacionin në lidhje me të drejtën e klientëve për të zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit, me dhënien e njoftimit;

dh) të dhënat e konsumit të tij, duke i mundësuar çdo klienti akses në leximin e aparatit të matjes dhe ndaj të dhënave të matjes, në bazë të një marrëveshjeje të qartë dhe pa pagesë;

e) të drejtat e tyre, në përputhje me udhëzuesin e miratuar nga Komuniteti i Energjisë.

3.4. Furnizuesit nëpërmjet faturës së konsumit të energjisë elektrike dhe/apo materialeve promovuese, informon në mënyrë të qartë klientët për:

a) konsumin faktik të energjisë elektrike

b) të dhëna për çdo burim energjie të siguruar nga furnizuesi gjatë vitit të mëparshëm;

c) elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse;

c) të dhënat për ndikimin në mjedis të gazit karbonik dhe mbeturinave radioaktive të emetuara gjatë prodhimit të energjisë elektrike, të siguruar nga furnizuesi në vitin e mëparshëm.

3.5. I licensuari i ngarkuar sipas ligjit me detyrimin për shërbimin universal do të sigurojë furnizimin me energji elektrike me çmime të rregulluara nga ERE vetëm për klientët fundorë që furnizohen sipas shërbimit universal të furnizimit, sipas parashikimit të nenit 83, pika 1 të ligjit nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike.

3.6. I licensuari i caktuar sipas ligjit si Furnizuesi i mundësisë së fundit është i detyruar të furnizojë klientët, të cilët mbeten pa furnizues, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim kur:

a) furnizuesi i mëparshëm është në kushtet e paaftësisë paguese ose është në proces falimentimi;

b) furnizuesit të mëparshëm i është hequr ose i është pezulluar përkohësisht licenca;

c) klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg.

3.7. Çmimi, me të cilin furnizuesi i mundësisë së fundit furnizon me energji elektrike, përcaktohet nga ERE sipas metodologjisë së miratuar prej saj, në përputhje me përcaktimet e neneve 21 dhe 79, pika 4 e ligjit.

3.8. të klientit fundor dhe pa kosto shtesë për të. Furnizuesi aktual është i detyruar të furnizojë klientin fundor deri në ndryshimin e furnizuesit.

4. Llogaritë dhe Raportimi

4.1. I Liçensuari do të mbaje regjistra llogarie dhe do të përgatise bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për Aktivitetin e Liçensuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licensuara) ku është angazhuar i Licensuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në përputhje me Ligjin 43/2015 “Per Sektorin e energjise elektrike”. I Liçensuari do t’i dorëzojë ERE-s bilance financiare vjetore deri në datën 31 Mars të çdo viti.

4.2. Nëse i Liçensuari parashikon një situatë emergjente siç përcaktohet nga Legjislacioni në fuqi, i Liçensuari do të njoftojë pa vonese ERE-n dhe ky njoftim do të përshkruajë çfarë masash do të marrë i Licensuari për të parandaluar ose përmirësuar ndikimet e situatës emergjente të parashikuar.

4.3. I Liçensuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes Aktivitetit të tij të Liçensuar dhe tipeve të tjera të aktiviteteve, në përputhje me Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s. I Liçensuari do t’i paraqesë ERE-s, me kërkesën e tij, në formën dhe në afatin e vendosur nga ERE, dokumentacionin që vendos bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta mes aktiviteteve që do të ushtrohen, si dhe rezultatet e arritura pas kësaj ndarje.

4.4. I Licensuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 diteve për çdo ndryshim të:

a) adresës;

b) statutit të të Liçensuarit;

c) çertifikatës së regjistrimit;

d) kodit fiskal;

e) organet kryesore drejtuese; ose

Nese i Liçensuari nuk e ben kete njoftim, ERE mund të vendos gjoba ne perputhje me ligjin 43/2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” si dhe Rregulloren per vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtesimit prej tyre

4.5. Gjithe njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjeter me ERE-n lidhur me Liçencen duhet të jete me shkrim dhe të nenshkruara respektivisht nga nje zyrtar i autorizuar ose perfaqesues ligjor i caktuar i të Licensuarit ose ERE-s, dhe të dergohet me korrier ose poste të regjistruar, duke kerkuar nje verifikim të fletes se marrjes. Adresat e Paleve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithe njoftimet ose korrespondenca tjeter do të konsiderohen se hyjne në fuqi nga momenti i dorezimit, ose nese nuk janë dorezuar për shkak të gabimit të derguesit, nga momenti i prezantimit.

4.6. I licensuari do të dergoje ne ERE informacion Periodik lidhur me:

- i. Shpenzimet dhe te ardhurat operative (mujore, dhe ne progresion 3-mujor);
- ii. Pasqyra Cash-Floë (mujore dhe progresive);
- iii. Tabela e energjise elektrike te furnizuar (mujore dhe progresive);
- iv. Cdo informacion te kerkuar rast pas rasti nga ERE
- v. Numrin e Klienteve te furnizuar (mujore dhe progresive)
- vi. Grafiket e ngrakeses
- vii. Sistemet e matjes
- viii. Te dhena mbi ankesat e rregjistrua, trajtimit dhe korrektimeve ne faturiemt perkatese objekt ankimi (mujore dhe progresive) .

5. Përdorimi i Informacionit

5.1 Liçensuari do të siguroje qe çdo informacion i marre si rezultat i Aktivitetit të tij të Liçensuar nuk do ti jepet askujt, me perjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pelqim paraprak me shkrim i Personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) informacioni është bere publik;
- c) kur të Licensuarit i kerkohet ose lejohet të perhape informacionin për të permbushur Kushtet e kesaj Liçence sipas nje urdheri të ERE-s, ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme;

d) informacioni duhet perhapur në funksion të kryerjes së aktivitetit të Liçensuar.

5.1.1 I Liçensuari do të sigurojë që çdo Biznes Shoqerues nuk do të perdore asnjë informacion të të Liçensuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion tek ndonjë Person tjetër (përfshirë Biznese të tjera Shoqerues) që mund ta mundesojnë këtë Person të fitojë çdo lloj përfitimi komercial të pajustificuar.

5.2 I Liçensuari do të ndermarre çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur konfidencial informacionin në posedim të tij dhe për t'i raportuar ERE-s në përputhje me detyrimet Ligjore.

5.2.1 Informacioni i dërguar ERE-s nga i Liçensuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të Liçensuarit, ERE me vendim përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.

5.2.2 I Liçensuari nuk do të hyjë në marrëveshje të cilat i Liçensuari e di ose duhet ta dijë që çojnë në shkelje të Kushteve të Liçencës.

5.2.3 I Liçensuari do të respektojë Ligjet dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Rregulloret e Rregullat e ERE-s.

6. Pagesat e Rregullimit

6.1 I Liçensuari do t'i paguajë ERE-s pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj Liçence siç përcaktohet nga ERE në rregulloren për pagesat e rregullimit siç është përcaktuar në nenin 17 të ligjit 43/2015 "për sektorin e energjisë elektrike".

6.2 Nëse i Liçensuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit brenda afatit të përcaktuar nga ERE, i Liçensuari do të penalizohet në përputhje me Ligjin Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".

7. Kontrolli mbi Kryerjen e Aktivitetit të Liçensuar

7.1. ERE do monitorojë zbatimin nga i Liçensuari të Kushteve të Liçencimit, do të shqyrtojë raportet e marra nga i Liçensuari dhe në çdo kohë pas njoftimit, është i

autorizuar të inspektoje asetet ose regjistrimet e llogarive dhe mund të kerkoje nje auditim teknik dhe/ose kontabel të aktiviteteve të te Licensuarit.

7.2. Perfaqesuesit e autorizuar të ERE-s kane të drejte të hyjne në ndertesat e të Licensuarit, pajisjet dhe dokumentat për te monitoruar Aktivitetin e Liçensuar në perputhje me Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s. I Liçensuari do të siguroje çdo informacion ose document të kerkuar, të nevojshme për ERE-n gjatë këtij monitorimi.

7.3. Në baze të ankeses se vertetuar të çdo Personi të trete ose në baze të vete propozimit të tij, ERE mund të nise nje hetim për zbatimin e Kushteve të Liçences ose Rregulloreve dhe Rregullave të ERE-s, perfshire shqyrtimin e praktikave të biznesit nga të Licensuarit lidhur me Aktivitetin e Liçensuar.

7.4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i Liçensuari nuk ka zbatuar Kushtet e Liçences dhe legjislacionin ne fuqi. , ERE mund të korrigojë tarifat e të Liçensuarit te ngarkur me pergjigjesine e Furnizuesit Universal dhe/ose të ndërmarrë masa të tjera ndaj te licensuarit sipas kesaj license me qellim qe të mbrojë interesat e konsumatoreve të energjise elektrike, duke ndershkuar ate me gjobe e deri në heqjen e kesaj Liçence.

7.5. I Liçensuari do të informojë ERE-n për çdo shkelje të këtyre Kushteve të Licencës dhe legjislacionit ne fuqi brenda një jave që kjo shkelje i bëhet e njohur të Liçensuarit.

7.6. I Liçensuari do të zbatojë të gjitha urdherimet apo vendimet e nxjerra nga ERE, përfshire pagesen e plotë të gjobave të vendosura nga ERE..

8. Amendamenti i Liçences

8.1. ERE mund të amendojë Kushtet e Liçences në rast se ato nuk përputhen me:

- a) Legjislacionin në fuqi dhe Vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë që janë në përputhje me Legjislacionin në fuqi;
- b) Vendimet e nxjerra nga Gjykata e Shkalles se Pare Tirane ose nje Gjykate tjetër Shqiptare me kompetence juridiksionale.

8.2 Në çdo kohe i Liçensuari ose ERE mund të propozojnë amendamente të tjere për keto Kushte Liçence, duke i transmetuar pales tjetër nje propozimi me shkrim, së bashku me dokumentet mbeshetese.

8.3 ERE do të marre vendimin perfundimtar vetem pasi të marre në konsiderate interesat e konsumatoreve dhe të liçensuarve të tjere. Palet e interesuara do të informohen me shkrim për çdo amendament të propozuar. Nese ERE dhe i Liçensuari arrijne nje marreveshje për keto amendamente, Kushtet e Liçences do të amendohen. Nese marreveshja nuk arrihet, i Liçensuari mund të apeloje në Gjykatën e Shkalles së Parë Tiranë.

8.4 Amendamentet e bera në Kushtet e Liçences do të publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë tridhjetë (30) dite para se të hyjnë në fuqi.

9. Përfundimi i Liçencës

9.1. ERE mund ta përfundojë Liçencën në përputhje me Ligjin 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s kur:

- a) i Liçensuari kërkon revokimin e liçences;
- b) i Liçensuari shkel Kushtet e Liçences;
- c) i Liçensuari shkel Legjislacionin në fuqi;
- d) i Liçensuari deklarohet i falimentuar dhe është i paaftë të përmbushë detyrimet e Kushteve të Liçences;
- e) i Liçensuari ka marre liçence duke mashtruar.

f) kur kontraktin me të treta për dhenien e shërbimit sipas aktivitetit të liçensuar ,

9.2. Nese i Liçensuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksioneri/ortaku që kontrollon interesin ndryshohet pa autorizimin e ERE-s, Liçenca bëhet nul (e pavlefshme) ose anulohet dhe pasuesi i të Licensuarit do të aplikojë për një liçencë të re në përputhje me procedurat e ERE-s për dhenie liçence.

10. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe e Drejta për Apelim

10.1. Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të Liçensuarit dhe çdo Pjesëmarrësi Tregu do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirekuptim, në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe Rregulloret dhe Rregullat e ERE-s.

10.2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirekuptim, atëherë ERE në bazë të kërkesës të çdo Personi që është palë në këtë mosmarreveshje do ta zgjidhë mosmarreveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me Legjislacionin në fuqi dhe Rregulloret dhe Rregullat e saj.

10.3. I Liçensuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë.